



**Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës**



Drejtoria për Administratë dhe Përsone

Zyra e Prokurimit

Nr. 03/ 03

Datë : 11.01.2022.

KONTRATË PROKURIMI Nr.02

Komuna e Malishevës, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një tërësi;

Dhe **Sylejman Telaku B.I. (N.P.SH. " Vllazërit Telaku ")** me seli në Malishevë me Nr.biznesi **810705345** (në vazhdim "Kontraktuesi"), në tërësi, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara me poshtë:

**FURNIZIM ME MIELL PËR FAMILJET ME KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE DHE SOCIALE
TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**

me numër identifikues : **62500-21-10234-1-2-1/62500-21-157-121**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimit në vijim nga ana e Kontraktuesit:

FURNIZIM ME MIELL PËR FAMILJET ME KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE DHE SOCIALE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i furnizimit : **19,800.00 €.(nëntëmbëdhjetë mijë euro)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në katëra origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Sylejman Telaku
Pozita:	Menagjer i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha përdorur	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: <u>GJUHA SHQIPE.</u>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	3.1	Kontraktuesi (OE) i bartë të gjitha rreziqet që mund të ndodhin gjatë kryerjes së furnizimit me miell për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Komunës së Malishevës lëndime personale, vdekje, humbje të pasuris përfshirë pa kufizime të gjithë pasurin si dhe rreziqe tjera që mund të ndodhin gjatë kryerjes së furnizimeve dhe lëndimeve që kanë të bëjnë me këtë kontratë.
Siguria e ekzekutimit	6.1	10% e vlerës së kontratës për 60 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Ofertimi i çmimeve	7.1	Çmimet e ofertuara nga OE duhet të jenë fikse dhe të pandryshara deri në realizimin e kontratës. Çmimi i kontraktuar vlen për tërë vlerën e furnizimit të kontraktuar deri në përfundim të kontratës.

Menaxhimi i Kontrates	8.1	Menaxhimin e kontratës dota bëjë zyrtari i caktuar i caktuar nga ZKA i AK-së. Menaxheri i kontratës është përgjegjes për mbikqyrjen e ekzekutimit të furnizimit me miell për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Komunës së Malishevës gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të furnizimit e deri në përfundim të kontratës. Menaxheri i projektit do të mbikqyrë OE gjatë tërë kohës sa zgjatë furnizimi duke filluar nga dita e parë e deri në përfundimin e kontratës përkatësisht ekzekutimin e kontrates. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë cilësinë dhe sasinë e furnizimit. AK e ruan të drejten që t'ia ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe sasinë në afatë dhe në përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës .
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	9.1	Të gjitha i përkasin OE.
Fillimi i furnizimit	10.1	Furnizim me miell për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Komunës së Malishevës do të fillojë brenda dy (2) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës por mund të fillojë edhe me herët nese OE është i përgatitur. Kjo vertetohet në raportin e menaxherit të projektit. - Ndërsa përfundimi i furnizimit me miell për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Komunës së Malishevës do të kryhet brenda 60 ditëve.
Vonesat në Ekzekutim	13.1	Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej furnizimin brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë Autoriteti Kontraktues pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Cilësia e furnizimeve	14.1	Furnizimi me miell për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Komunës së Malishevës duhet të jetë në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmeri të plotë në specifikacionin e ofertës. Nëse furnizimi nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar do të i kthehet OE dhe shpenzimet e bëra do të bien në llogari të OE.
Pagesa	15.1	Pagesa do të bëhet në Euro.
Pagesat	16.1	Obligohet AK që pasi ta e pranon raportin e pranimi të Furnizimit me miell për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Komunës së Malishevës nga zyrtari përkatës (menaxheri i kontratës) si dhe faturen nga OE të ia paguaj shumen sipas nenit 2 dhe 2.1 të kësaj kontrate. Pagesat OE do të i bëhen në bazë të raportit të menaxherit të projektit ndërsa pagesa finale do të bëhet në bazë të raportit të menaxherit të kontratës dhe raportit të një komisioni të caktuar nga ZKA i AK-së.
Pranimi i furnizimit	17.1	Pranimi i furnizimit me miell për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Komunës së Malishevës do të bëhet nga menagjeri i kontratës dhe komisioni i caktuar nga ZKA i AK-së.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	20.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e furnizimit që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e furnizimit.

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	21.1	Palët do të mundohen që çdo marrëveshje ta zgjedhin me marrëveshje miqësore.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	22.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykatën kompetente në pajtim me ligjin në Kosovë.

PJESA II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PJESA<Nr>	PERSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJË PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1.	Furnizimi me miell të cilësis së lartë TIP 500	KG	45000	0,4074	1466,67	0,4400	19,800.00€
TOTALI I PËRGJITHSHËM :							19,800.00€

